



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

DATE:

23/11/2022

Nr: 11/

Më: / /2022

Nr.No.Br.

11/2059

Në bazë të nenit 68 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë e në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011 nenit 34 dhe 35 Udhëzimit Administrativ (MPMS)Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Viti shkollor -2022/2023

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri pozitivave	Orë
2	SHFMU" 17 Shkurti" në Begaj	Matematikë	Zëvendësim i lehonisë	1	16

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit(ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Çertifikata e lindjes

II. Kushtet dhe Kualifikimi:

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim përkatës, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në ueb- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës. Data e aplikimit është nga dt,23.11.2022 deri më 07.12.2022, në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushte të konkursit.

Në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

The image shows a circular official stamp of the Malisheva Municipality. The text within the stamp includes 'KOMUNA E MALISHEVËS' and 'Zyra e Qytetarëve'. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink.